



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E FINANCAVE

Drejtoria Përgjithshme e Tatimeve

Nr. 15338 Prot. Datë 09.6.14



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
ILDKPKI

Nr. 3436 Prot. Datë 10.6.14

AKT - MARRËVESHJE

PËR

PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE TË BASHKËVEPRIMIT DHE BASHKËPUNIMIT MES PALËVE PËR SHKËMBIM INFORMACIONI PËR VERIFIKIMIN E DEKLARATAVE INDIVIDUALE VJETORE TË TË ARDHURAVE

Bazuar në Ligjin Nr.9920, Datë 19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 61 **Detyrimi i të tretëve për të dhënë informacion**, neni 62, **Personat, të cilëve u adresohet kërkesa për të dhënë informacion**, neni 24, 25, pika 5) **Konfidencialiteti**, ku dispozitat e këtij ligji përcaktojnë kuadrin e bashkëpunimit ndërinstytucional për sigurimin e informacionit në funksion dhe mbështetje të nenit 13, **Deklarata Individuale Vjetore e të Ardhurave**, në Ligjin.Nr.8438 Datë 28.12.2008 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar, me përjashtim të rasteve kur me ligje të veçanta është parashikuar ndryshe, si dhe bazuar në Ligjin Nr.9049, Datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nënpunësve publikë”, i ndryshuar, neni 17, germa ç) Kompetencat e Inspektoratit të Lartë, me qëllim përcaktimin e kuadrit ligjor për thellim të bashkëpunimit konkret ndërinstytucional.

Kjo Marrëveshje Bashkëveprimi (më poshtë referuar si Akt-Marrëveshje) lidhet ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Inspektoratit të Lartë të Deklarimit, Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, të referuara si “Palët”.

Termet e Marrëveshjes

Termet e përdorur në këtë Marrëveshje dhe gjatë zbatimit të saj do të kenë të njëjtin kuptim si përkufizohen në ligjet bazë të Institucioneve të Pavarura, të cilat mundet ose jo të varen prej tyre direkt apo indirekt.

Shtrirja e Marrëveshjes

Në nivel Institucional (Institucione të Pavarura)

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, do të angazhohet në këtë Marrëveshje Bashkëveprimi me të gjitha Institucionet e Pavarura apo organizmat privatë dhe njësitë e varësisë së tyre në mbarë vendin, në zbatim të Ligjit Nr.9920, Datë 19.05.2008;

- në referencë të neneve 24, 25 “Dhënies së informacionit tatimor” dhe “Konfidencialitetit”
- në referencë të neneve 61, 62, “Detyrimit të personave të tretë për të dhënë informacion” dhe “personave të cilëve i adresohet kërkesa për informacion”.

Ligjit Nr.8438, Datë 28.12.1998 “Për Tatimin Mbi të Ardhurat”, i ndryshuar
- në referencë të nenit 13, 14, Deklarata Individuale Vjetore e të Ardhurave.

Inspektoriati i Lartë, do të angazhohet në këtë marrëveshje bashkëveprimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, bazuar në domosdoshmërinë e shkëmbimit të të dhënave që institucionet disponojnë, në zbatim të nenit 17, pika ç) e Ligjit Nr.9049, Datë 10.04.2003, Kompetencat e Inspektoratit të Lartë i cili bashkëpunon me organet e auditimit dhe me struktura të tjera përgjegjëse për luftën kundër korrupsionit dhe krimin ekonomik.

Në nivel Informacioni

Informacioni periodik, por jo më shumë se çdo gjashtë muaj, lidhur me të dhënat që Inspektoriati i Lartë zotëron, duke i vënë në funksion të DPT, për evidentimin e informacionit në funksion të deklaratave të të ardhurave individuale vjetore me qëllim verifikimin e plotë të tyre. Në çdo rast informacioni i dhënë duhet të jetë në përputhje të plotë me kërkesat e Legjislacionit në fuqi dhe asnjëherë në tejkalim të parashikimeve dhe qëllimit të ligjit.

Palët kanë rënë dakort si më poshtë:

1. Qëllimi

Duke u nisur nga qëllimi i përbashkët për forcimin e shtetit ligjor, luftës kundër korrupsionit, krimin ekonomik, evazionit fiskal, veprimeve që çënojnë mirëfunksionimin e administratës publike dhe mbrojtjen e interesave të shtetit, marrëveshja synon, të sigurojë vënien në dispozicion të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të kapaciteteve teknologjike dhe informacionit të nevojshëm nga ana e Inspektoratit të Lartë për verifikimin e deklaratave të të ardhurave individuale, për aq informacion sa zotëron ky institucion. “Palët” do të bashkëpunojnë në mënyrë të ndërsjelltë për mbarëvajtjen e proceseve të hartimit dhe zbatimit të rregullave që garantojnë sigurinë e të dhënave personale që përpunohen nga strukturat tatimore.

2. Objekti

Kjo marrëveshje rregullon bashkëpunimin midis palëve, me qëllim mbështetjen e strukturave të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, gjatë ushtrimit të detyrave dhe kompetencave ligjore për përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale dhe mbledhjen e të ardhurave të tatueshme në zbatim dhe respektim të ligjeve të posaçme për mbrojtjen e lirive themelore të njeriut në përgjithësi si dhe shërben si mbështetje për zbatimin korrekt dhe efikasitet të Legjislacionit tatimor në fuqi.

3. Detyrimet e “Palëve”

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE (DPT)

- a. DPT është institucioni përgjegjës për zbatimin uniform të ligjeve dhe rregulloreve që kanë të bëjnë me tatimet kombëtare, pagesat publike dhe mbledhjen e kontributeve.
- b. DPT merr përsipër të garantojë zbatimin e rregullave që garantojnë sigurinë e të dhënave personale që përpunohen nga strukturat tatimore. (Ligji Nr.9920, Datë 19.05.2008, neni 25)
- c. DPT merr përsipër që të shkëmbejë me ILDKPKI listën e individëve që deklarojnë të ardhura bruto vjetore mbi 2 milion lekë për ato të dhëna që disponojnë dhe në rastet e konstatimit jo të saktë apo jo të vërtetë të njoftoje ILDKPKI.

INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE (ILDKPKI)

ILDKPKI merr përsipër, në bazë të të dhënave që gjeneron nga sistemi HIDAA CMS, që në mënyrë periodike, por jo më shumë se çdo gjashtë muaj, t'i vë në dispozicion DPT, listën elektronike dhe fizike të subjektëve deklarues dhe familjarëve të tyre, të cilët deklarojnë të ardhura vjetore mbi shumën prej 2 milion lekë, me qëllim kryerjen e verifikimeve të mëtejshme nga DPT.

4. Organizimi dhe përmbushja e detyrimeve

- a. “Palët”, do të sigurojnë mbështetjen e nevojshme menaxheriale, administrative dhe logjistike për përmushjen e detyrimeve të specifikuar në këtë Marrëveshje.
- b. “Palët”, do të sigurojnë personelin e nevojshëm të kualifikuar dhe me eksperiencë për realizimin në mënyrën e duhur të Marrëveshjes dhe do të marrin përsipër përgjegjësitë menaxheriale dhe teknike për të përmbushur detyrimet e tyre përkatëse ashtu siç përcaktohen në këtë Marrëveshje.
- c. Me qëllim lehtësimin dhe sigurimin e një komunikimi të vazhdueshëm për zbatimin e kësaj marrëveshje “Palët” do të caktojë një person kontakti që do të jetë përgjegjës për zbatimin konkret, person i cili komunikohet shkresërisht nga “Palët”.

5. Raportimi dhe Komunikimi

- a. Të gjitha materialet, raportet si dhe të gjitha komunikimet e tjera midis “Palëve” do të bëhen nga personat e kontaktit të përcaktuara nga “Palët” respektive.
- b. Në çdo rast komunikimi dhe informacioni mes “Palëve” do të jetë në formë shkresore (në zarf të mbyllur) me qëllim respektimin e konfidencialitetit.
- c. Për të bërë të mundur zbatimin me korrektësi të marrëveshjes dhe për të kontrolluar efikasitetin e funksionimit të saj, përfaqësues të dy institucioneve duhet të organizojnë takime të përbashkëta (referuar periudhës së raportimit periodik).

6. Konfidencialiteti

- a. Gjatë zbatimit të Marrëveshjes, “Palët” mund të shkëmbejnë informacione të cilat ata i konsiderojnë konfidenciale. Të gjitha të dhënat e shkëmbyera midis “Palëve” do të konsiderohen konfidenciale dhe do të menaxhohen nga persona të caktuar nga “Palët” në Marrëveshje, përveç rasteve kur ato përcaktohen ndryshe me shkrim.
- b. “Palët” bien dakord të ruajnë njëri-tjetrin të pacënuar nga ndonjë dëmtim ose humbje që rrjedh direkt ose indirekt si rezultat i ndonjë aktiviteti të “Palës” tjetër, si pasojë e përmbushjes së Marrëveshjes.

7. Hyrja në fuqi

- a. Marrëveshjes, nuk mund t’i bëhet asnjë ndryshim në mënyrë të njëanshme, përveçse me shkrim, si dhe pasi “Palët” të kenë rënë dakort paraprakisht midis tyre dhe të kenë autorizuar ndryshimin nëpërmjet nënshkrimit nga titullarët e “Palëve”.
- b. Çdo mosmarrëveshje krijuar mbi interpretimin ose ekzekutimin e kësaj Marrëveshje do të zgjidhet me marrëveshje ndërmjet dy “Palëve”.
- c. Marrëveshja do të hyjë në fuqi me nënshkrimin nga “Palët”, dhe do të mbetet në fuqi deri në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin prej saj.

Kjo Marrëveshje Bashkëveprimi u nënshkrua sot më datë 10.06.....2014.

Për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
BRISIDA SHEHAJ



Për Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave

INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM
SHKËLQIM GANAJ

